LIGJ
Nr. 92/2015

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.22/2014 "PËR DHËNIE AMNISTIE"

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2,shkronja "ë", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 3, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:

"d) personat e dënuar me burgim për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, kur vepra penale është kryer jo më vonë se data 10 prill 2014."

Neni 2

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale në fjalë është kryer jo më vonë se data 10 prill 2014."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9204, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani